



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublancës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0482

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedit Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Botek shpk, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative me numër të prokurimit 632-23-5132-5-5-8, me 02/10/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Botek” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.07.2023 (me numër protokolli 482/23), vendimi për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative”, me nr. të prokurimit: 632-23-5132-5-5-8, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves, anulohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në ri-vlerësim.

2. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankesues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 22.05.2023, Komuna e Gjakoves. , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative” me nr. të prokurimit: "632-23-5132-5-5-8". Nderkaq me datën 22.06.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Botek” SH.P.K. me datën 27.06.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK-Komuna e Gjakoves. me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Botek” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative” me numër të prokurimit: 632-23-5132-5-5-8 iniciuar nga Komuna e Gjakoves.

AK ne vendim ka kërkuar te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin per dhënie i AK –Komuna e Gjakoves lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje te Teknologjis Informative” me numër te prokurimit. 632-23-5132-5-5-8.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues“Botek” SH.P.K. me datën 11.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 482/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 102,897.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 26.07.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Botek” SH.P.K.

Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Botek” SH.P.K. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 11.07.2023 (me numër protokollit 482/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje te Teknologjise Informative “ me nr. të prokurimit: "632-23-5132-5-5-8", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakoves.

Të anulohet aktiviteti i prokurimit dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesën në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së

cituar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjakovës, gjatë këtij aktiviteti ka zbatuar procedurën e mini tenderëve përmes ftesës për ofertim, bazuar në kontratën publike kornizë me disa OE të lidhur nga AQP-ja, me titullin “Furnizim me pajisje të teknologjisë informative”, sipas Kontratës Kornizë me numër UA/2016-19-9628-1-1-1/FA-153 e nënshkruar më datë 31.08.2020, e cila është vlefshme për dy vite.

Ftesa për ofertim (FPO) është dërguar për OE-të e parakualifikuar më datë 22.05.2023, ndërsa afati për dorëzimin e ofertave ishte data 05.06.2023.

Më datë 22.06.2023, AK ka publikuar njoftimin lidhur me vendimin e saj, ku ka rekomanduar për kontratë OE "Aritech". Pasi OE ankuese ishte i pakënaqur me vendimin e AK-së, më datë 27.06.2023 ka paraqitur një Kërkesë për Rishqyrtim te AK-ja dhe ka ngritur pretendime të njëjta si në ankesën aktuale. Më datë 04.07.2023, AK ka marrë një vendim lidhur me refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

OE-ja ankuese, e pakënaqur me këtë vendim të AK-së, më datë 11.07.2023, ka paraqitur një ankesë në OSHP.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës e konteston ofertën e OE-së të rekomanduar për kontratë. Në veçanti, OE ankues pretendon se OE-ja e rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar një specifikim teknik të detajuar të pajisjeve të ofruara, ashtu siç kërkohet nga Marrëveshja Publike Kornizë, që është baza e Ftesës për Ofertim (FPO).

Në përgjigje të pretendimit të OE ankues lidhur me këtë çështje, vlerësojmë se problemi ka të bëjë me lëshimin e bërë nga AK në FPO që është dërguar te OE-të. Konkretisht kushtet e tenderit të përcaktuar në Nenin IV në FPO nuk pasqyrojnë kërkesat e Marrëveshjes Kornizë bazë, në të cilën specifikohet “ Shënim:- *Te plotësohen me saktësi dhe qartësi kolonat ne te djathte "Specifikacioni teknik minimal i ofruar" dhe secila informatë aty duhet te përputhet me katalogun te cilin e ofroni, pra gjithsecila informatë e plotësuar nga ju duhet te jete edhe ne katalog qe te mund te vërtetohet gjate vlerësimit. Ku kërkohet "minimumi" ose "or better" ju duhet te shkruani saktë se çfarë ofertoni ndërsa kur kërkesa është e prere si p.sh "Mausi dhe tastieri: USB Mouse & QWERTY Keyboard" ju mund ta plotësoni me "?" ose x"*

-Për secilin produkt duhet te specifikoni emrin e modelit qe e ofertoni. Ne kolonën e pare te secilit produkt tek - Prodhuesi - Brand Name dhe ne kolonën e fundit duhet te shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë te modelit te cilin e ofroni.

- Sistemi operativ i ofruar duhet te jete i licencuar.

- Tek lapotopet duhet te ofronin çanta te cilat duhet te jene te njëjtit prodhues e përfshirë ne konfiguracion.....”

Në një situatë të tillë AK duke mos specifikuar në FPO se dokumenti i specifikimeve teknike duhet të përfshijë edhe informatat për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuara si dhe katalogun, si informata të cilat kërkohen nga kushtet e marrëveshjes bazë, ka lënë mundësinë që OE-të të ofertojnë pa dhënë informacion se me cilat produkte ofertojnë rrjedhimisht edhe krijojnë paqartësi në pranimin e pajisjeve duke e ditur që në procedurë konkretisht në kontratë nuk dihet se cili do të jetë modeli që duhet të liferohet, përkatësisht pranohet.

Eksperti shqyrtues sqaron se Marrëveshja kornizë ishte lidhur me AQP-në dhe mini tenderët duhet të përmbahen nën 54.40 të rregullores për prokurim publik me nr. 001/2022 Zhvillimi i procedurës (mini tenderimi) në rastet e aktiviteteve të prokurimit qendror të zhvilluar nga ana e Agjencinë Qendror të Prokurimit në emër të Autoriteteve të tjera kontraktuese duhet të zhvillohet nga vetë Autoriteti kontraktuese kurdo që lind nevoja.

Ndërsa nën 54.41 parasheh që Mini-tenderimi duhet të jetë në bazë të “ kushteve të njëjta dhe nëse është e nevojshme sipas termeve të formuluar si dhe kurdo që është e përshtatshme termave të tjera të cilave ju referohet specifikimi në kontratën publike kornizë”. Kjo i nënshtrohet ndalimit (shmangie ose kufizime esenciale) prej termave të përcaktuar në kontratën publike kornizë.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky lëshim në FPO nga AK, është i pa-përmirësueshëm në këtë fazë andaj rekomandohet të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit konform nën 62 paragrafi 1.1 *“një shkelje e ligji aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”*. Nëse AK ka interes përsëri për iniciimi e mini tenderëve duhet të përgatit ftesë për ofertim me kritere të qarta dhe në përputhje me marrëveshje kornizë të nënshkruar nga AQP-ja.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues administroi me të gjitha shkresat e kësaj lënde, duke i analizuar të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve të cilat (në përmbledhje) i shqyrtoi si në vijim:

Pohimet ankimore të OE ankues

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK nga aspekti i përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, ngase kundërligjshëm ka shpall fitues një OE i cili nuk ka dërguar specifikim teknik të detajuar të pajisjeve të ofruara, ashtu sikurse kërkohet me LPP (Neni 28), RRUOPP, Pika 20 dhe Marrëveshjen Publike Kornizë si bazë e kësaj Ftese për Ofertim. Në Aneksi 1_Specifikimet Teknike të Detyrueshme, të kësaj Marrëveshje Publike Kornizë, saktësohet qartë se, cit: Për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek ☐ Prodhuesi- Brand Name dhe në kolonën e fundit dueht të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni. Lidhur me këtë eksperti shqyrtues ka konstatuar se AK ka bërë lëshime sepse tek dokumenti i specifikimeve teknike duhet të përfshijë edhe informata për modelet dhe specifikimet e pajisjeve të ofertuara dhe lëshim në FPO nga AK, është i pa-përmirësueshëm në këtë fazë andaj rekomandohet të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit. Për panelin shqyrtues nuk paraqet

pasqyrim të gjendjes reale, ngase ne dokumentacionin e këtij aktiviteti rezulton se ne ofertën e OE përkatësisht Specifikimet teknike, ne asnjë vend nuk precizohet Prodhuesi se me çfarë pajisje oferton. Pra, duke ju referuar dokumentacionit të këtij aktiviteti të prokurimit rezulton se OE i shpallur fitues për këtë procedurë pikërisht tek specifikimet teknike të detyruara të ofruara në ofertën e tij nuk përcakton ne asnjë vend brendin apo prodhuesin e pajisjeve të cilat do të liferoj apo me të cilët ka aplikuar. I vetmi dokument i cili është relevant për këtë aktivitet është deklarata e OE i cili thekson se të gjitha produktet janë sipas specifikimet të kërkuara mirëpo prap edhe në deklaratën e tij nuk specifikohet brendi apo prodhuesi me të cilin oferton.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se një pjesë e pohimeve ankimore janë pjesërisht të bazuar, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 59 dhe 60 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit në ri-vlerësim, me fakte dhe prova kontestuese dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: